REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHIJAK
DREJTORIA JURIDIKE

Nr 6154 **Prot**

Shijak, më 28.10.**2026**

NJOFTIM

PËR VIJIMIN E PROCESIT TË RINDËRTIMIT DERI NË PËRFUNDIM TË SAJ , PËR KALIMIN E PRONËSISË SË APARTAMENTEVE TË NDËRTUARA NË KUADËR TË PROCESIT TË RINDËRTIMIT

Bashkia Shijak në mbështetje të nenit 100 te Kushtetutës , Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë nr 7850 datë , ligjit nr 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"i ndryshuar, Aktit normativ nr 6 datë 16.12.2019 'Për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore", Vendimit e Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr 51, datë 27.01.2021 "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr.904, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit", VKM nr 201/204'Për kalimin te bashkitë Mirditë, Vorë dhe Shijak të njësive të banimit në ndërtesat pallat, VKM nr 482/2026"Për kalimin te bashkitë Vorë dhe Shijak të njësive të banimit në ndërtesat pallat;

- Fton përituesit nga procesi i rindërtimit të akomoduar në njësitë e banimit (pallate) të paraqiten pranë bashkisë Shijak (**zyra e Informacionit**) për nisjen e procesit të kalimit të pronësisë për apartamentet përkatëse .

- Lutemi të jeni të paisur me dokumentacionin e përfitimit (proces verbal i shorteut), mjet identifikimi ID të aplikuesit dhe certifikatë familjare të aplikuesit .

- Personat përfitues të cilët në pamundësi për tu paraqitur personalisht gjatë kësaj periudhe për vijimin e këtij procesi nuk përjashtohen nga e drejta për kalimin e

pronësisë , megjithatë duhet të marin masa për të bërë të mundur prezencën e tyre dhe të mund të finalizohet procesi i kalimit të pronësisë .

- Personat përfitues të cilët kanë ndëruar jetë , familjarët e tyre të paraqesin dokumentacionin provues të dëshmisë së trashëgimisë.

Orari i punës e Hënë deri në të Premte 08:00-16:00

Drejtore juridike A.Mehmeti

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Tauland Xheraj